

**Zyra Kombëtare e Auditimit e Kosovës  
Nacionalna Kancelarija Revizije Kosova  
Kosovo National Audit Office**

# STRATEGJIA PËR KOMUNIKIM E ZYRËS KOMBËTARE TË AUDITIMIT TË KOSOVËS 2020 – 2022



**Prishtinë, 3 korrik 2020**

## TABELA E PËRMBAJTJES

Fjala e Auditorit të Përgjithshëm.....	3
Akronimet .....	4
1. Rreth nesh .....	5
2. Parathënie .....	6
3. Vizioni, misioni, dhe vlerat e ZKA-së .....	7
4. Parimet e komunikimit të ZKA-së .....	8
5. Palët e jashtme kyçe të interesit .....	9
6. Qëllimi i përgjithshëm i komunikimit .....	12
7. Qëllimet strategjike të komunikimit .....	12
7.1. Qëllimi 1 - Promovimi i rolit kushtetues të ZKA-së dhe ngritja e vetëdijesimit publik për rezultatet e auditimit .....	13
7.2. Qëllimi 2 - Rritja e llogaridhënies në sektorin publik përmes bashkëpunimit intensiv me Parlamentin.....	15
7.3. Qëllimi 3 - Rritja e mëtejshme e ndikimit të punës së auditimit .....	16
7.4. Qëllimi 4 - Komunikimi aktiv dhe pjesëmarrja në aktivitete ndërkombëtare .....	18
8. Mjetet dhe kanalet e komunikimit .....	19
9. Rolet dhe përgjegjësitë .....	20
10. Zbatimi, raportimi dhe vlerësimi.....	21

## FJALA E AUDITORIT TË PËRGJITHSHËM

Të nderuar qytetarë të Republikës së Kosovës,

Të nderuar deputetë në Parlament dhe partnerë të Zyrës Kombëtare të Auditimit,



Roli i Zyrës Kombëtare të Auditimit të Kosovës (ZKA), ashtu si edhe ai i të gjithë Institucioneve Supreme të Auditimit (ISA), është të ndihmojë institucionet shtetërore në përmirësimin e performancës së tyre dhe në ofrimin e shërbimeve publike duke këqyrë me imtësi shpenzimet publike. Ofrimi i informacionit të besueshëm mbi menaxhimin e financave publike dhe performancën e organizatave buxhetore ndihmon Parlamentin, Qeverinë dhe institucionet e tjera përkatëse publike, që t'i shërbejnë më mirë qytetarëve.

ZKA-ja përmbushë mandatin e saj duke ofruar produktet e auditimit për interesin e publikut. Për ta arritur këtë, ZKA-ja angazhohet të hartojë

raporte auditimi të një cilësie të lartë, ku të gjeturat dhe rekomandimet e auditimit të bazuara në prova, paraqiten në një mënyrë më të kuptueshme për lexuesit.

Një nga standardet kryesore të Organizatës Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (INTOSAI)<sup>1</sup> është që Institucionet Supreme të Auditimit (ISA) t'i identifikojnë qartë palët e tyre të interesit dhe të komunikojnë në mënyrë efektive me ta. Ky komunikim i ngushtë siguron që të kuptohen më mirë roli dhe përgjegjësitë e ISA-së, si një institucion i pavarur i sektorit publik. Për ta arritur këtë, INTOSAI inkurajon ISA-të të përcaktojnë një strategji për komunikim dhe për angazhimin e palëve të interesit, e cila përfshin parimet e tyre në këtë drejtim.

Raportet e saj të auditimit ofrojnë informacion, jo vetëm për entitetet e audituara, por edhe për institucionet qendrore dhe lokale, median si dhe për qytetarët<sup>2</sup>. ZKA-ja e sheh median si partnerin e saj strategjik në komunikimin e mesazhit të saj te publiku.

Plani Strategjik 2018-2021 i Zyrës Kombëtare të Auditimit të Kosovës parashikon hartimin dhe zbatimin e një strategjie për komunikim efektiv me palët e jashtme dhe publikun.

Strategjia e Komunikimit 2020-2022 përqendrohet në rrjedhën efektive dhe të pandërprerë të informacionit mes ZKA-së dhe palëve të saj të interesit. Ajo, gjithashtu kontribuon në zbatimin e misionit, vizionit dhe qëllimeve strategjike të ZKA-së, si një institucion që mbështet funksionimin më të mirë të shtetit.

Besnik Osmani

Auditor i Përgjithshëm i Kosovës

Prishtina, qershor 2020

<sup>1</sup> INTOSAI P-12-Vlerat dhe përfitimet, sjellja e ndryshimit në jetën e qytetarëve

<sup>2</sup> SNISA 300 – Parimet themelore të auditimit të performancës (Neni 41)

## Akronimet

AP	Auditor i Përgjithshëm
EUROSAI	Organizata Evropiane e Institucioneve Supreme të Auditimit
GJEA	Gjykata Evropiane e Auditorëve
INTOSAI	Organizata Ndërkombëtare e Institucioneve Supreme të Auditimit
ISA	Institucionet Supreme të Auditimit
KBT	Komisioni për Buxhet dhe Transfere
KISP	Korniza e INTOSAI-t për Standardet Profesionale
KMFP	Komisioni për Mbikëqyrje të Financave Publike
OB	Organizatë Buxhetore
OSHC	Organizata e Shoqërisë Civile
SNISA	Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit
ZKA	Zyra Kombëtare e Auditimit e Kosovës
NP	Ndërmarrje Publike

## 1. RRETH NESH

Auditori i Përgjithshëm i Republikës së Kosovës është institucioni më i lartë i kontrollit ekonomik e financiar, i cili, sipas Kushtetutës dhe ligjeve të Republikës së Kosovës, është i pavarur nga ana funksionale, financiare dhe operative. Zyra Kombëtare e Auditimit është institucion i pavarur, i cili e ndihmon Auditorin Përgjithshëm në kryerjen e detyrave të tij/saj.

**Mandati:** Sipas Kushtetutës dhe kornizës ligjore, Auditori i Përgjithshëm (AP) ushtron detyrat dhe përgjegjësitë e tij/saj në mënyrë të pavarur nga ana funksionale, financiare dhe operative. AP i raporton Kuvendit të Kosovës dhe ka të drejtën të kontrollojë të gjitha aktivitetet, programet dhe projektet financiare, administrative e të tjera të menaxhuara nga institucionet publike, përfshirë proceset dhe të ardhurat nga shitja e pasurive, privatizimi dhe koncesionet. AP kryen auditime të rregullsisë të Buxhetit të Kosovës dhe të gjitha organizatave Buxhetore (OB) si dhe të Ndërmarrjeve Publike (NP). Ai kryen gjithashtu auditime të performancës. AP ka të drejtën të përcjellë fondet publike deri tek përfituesi i fundit. AP ushtron mandatin e tij/saj në pajtim me legjislacionin vendor dhe Kornizën e INTOSAI-t për Standardet Profesionale (KISP)

**Aktiviteti i auditimit dhe burimet njerëzore:** Çdo vit, ZKA-ja harton dhe dërgon në Kuvend dhe entitetet e audituara mbi njëqind (100) raporte të auditimit të rregullsisë dhe të performancës. Mbi 1000 rekomandime auditimi u jepen OB-ve dhe NP-ve çdo vit. Të gjitha raportet e auditimit bëhen publike.


Aktualisht, ZKA ka 171 të punësuar, 141 prej të cilëve janë staf auditues.

## 2. PARATHËNIE

ZKA-ja e njej rëndësinë e ofrimit të informacionit te Parlamenti dhe publiku i gjerë rreth mënyrës se si Qeveria i menaxhon burimet shtetërore. Prandaj, strategjia e komunikimit e një Institucioni Suprem të Auditimit është një mjet thelbësor për promovimin e praktikave më të mira, llogaridhënies dhe transparencës për aktivitetet e institucioneve publike. Duke përmirësuar marrëdhëniet me palët e interesit, ne ofrojmë bazën për njohuri të përbashkëta, e cila kontribuon në sigurimin e efektivitetit, efikasitetit dhe përmirësimin e ndikimit të punës sonë.

Kjo strategji komunikimi përcakton qëllimet dhe objektivat që ZKA-ja kërkon të arrijë gjatë viteve në vijim, 2020-2022, në përputhje me Planin e vet Strategjik 2018-2021.

Figura 1. KISP të përdorura për hartimin e këtij dokumenti



### 3. VIZIONI, MISIONI, DHE VLERAT E ZKA-SË

#### VIZIONI

*“Institucion i besueshëm i auditimit, që përmirëson qeverisjen në sektorin publik, në interes të qytetarëve”*

#### MISIONI

*“Përmes auditimeve cilësore fuqizon llogaridhënien në administratën publike për përdorimin efektiv, efikas dhe ekonomik të burimeve kombëtare”*

#### VALUES

##### *Pavarësia*

Pavarësi nënkupton që i gjithë procesi i auditimit t'i nënshtrohet vetëm kërkesave të standardeve profesionale dhe ligjeve relevante, si dhe të jetë jashtë ndikimit të palëve të treta. Pavarësia është kyçe për të fituar besimin e publikut dhe Kuvendit të Kosovës duke iu ofruar atyre informacion të besueshëm dhe jo të njëanshëm.

##### *Profesionalizmi*

ZKA-ja udhëhiqet në veprimtarinë e saj audituese, nga standardet profesionale të INTOSAI-t dhe nga praktikat më të mira të vendeve të Bashkimit Evropian.

##### *Integriteti*

ZKA-ja angazhohet për mishërimin e vlerave më të mira etike, profesionale dhe morale. Veprimtaria e auditimit kryhet jashtë çdo konflikti të interesit.

##### *Transparenca*

ZKA-ja i ofron publikut të gjerë informacion të audituar, në pajtim me rregullat ligjore dhe standardet profesionale. ZKA-ja është e zotuar ta promovojë transparencën te entitetet e audituara si një element i qeverisjes së mirë.

## 4. PARIMET E KOMUNIKIMIT TË ZKA-SË

### Të bazuar në fakte

Produktet e ZKA-së janë rezultat i procesit të saj të auditimit të kryer me profesionalizëm, përfshirë kontrollin dhe sigurimin e duhur të cilësisë.

### I qartë

ZKA-ja komunikon mesazhin e saj në mënyrë koncize dhe të kuptueshme për përdoruesin.

### Me kohë

Mesazhi i ZKA-së jepet brenda afateve të përcaktuara nga korniza ligjore dhe bazuar në nevojat dhe interesin aktual të publikut.

### Angazhues

ZKA-ja inkurajon palët e interesit të përdorin produktet e saj të vlefshme për qëllimet e tyre dhe për interesin publik.

### Gjithëpërfshirës

Produktet e ZKA-së u dedikohen të gjithë qytetarëve të Kosovës, pavarësisht përgatitjes së tyre profesionale. Ato janë në dispozicion në gjuhët zyrtare të Republikës së Kosovës.



## 5. PALËT E JASHTME KYÇE TË INTERESIT

Angazhimi i ZKA-së me partnerët strategjikë dhe palët e interesit është konstruktiv. Megjithatë, nevoja për të zhvilluar një qasje sistematike komunikimi me palët e interesit është e dukshme. Kjo do të ndihmonte ZKA –në që t'i ofrojë publikut të gjerë njohuri më të mira për rolin dhe mandatin e saj, si dhe të kuptojë pritshmëritë e palëve të interesit.

Kush është palë interesi i ISA-së? INTOSAI-P12 (Vlerat dhe përfitimet e ISA-ve - sjellja e ndryshimit në jetën e qytetarëve) e përcakton palën e interesit si një person, grup, organizatë, anëtar ose sistem, i cili mund të ndikojë ose të ndikohet nga veprimet, objektivat dhe politikat e Qeverisë dhe entiteteve publike.<sup>3</sup>

Për të përcaktuar nevojat dhe kërkesat për komunikim me audiencën e synuar (palët e interesit), ZKA-së i duhet të ruajë marrëdhënie të mira me Legjislativin dhe Ekzekutivin në mënyrë që të inkurajojë zbatimin e ligjit dhe të lehtësojë mbikëqyrjen dhe llogaridhënien publike. ZKA-ja duhet të ruajë marrëdhënie të mira edhe me median dhe OSHC-të për të siguruar që të gjeturat e saj arrijnë te qytetarët (që janë dhe klienti kryesor i saj)

Palët kyçe të interesit për t'u marrë në konsideratë janë:

- ⇒ Parlamenti dhe komisionet e tij;
- ⇒ Ministritë, agjencitë, komunat, NP-të dhe entitetet e tjera të audituara;
- ⇒ Qytetarët e Kosovës;
- ⇒ Media;
- ⇒ OSHC-të;
- ⇒ Donatorët;
- ⇒ Shoqatat akademike dhe profesionale;
- ⇒ Partnerët ndërkombëtarë (INTOSAI, EUROSAL dhe organizata të tjera);

Tabela e mëposhtme paraqet pritshmërinë kryesore nga angazhimi me palët tona kyçe të interesit.

---

<sup>3</sup> Udhëzuesi për angazhimin e institucioneve supreme të auditimit me palët e interesit, fq.14.

Tabela 1. Paraqitja e palëve të interesit dhe pritshmërive nga angazhimi

Pala e interesit	Pritshmëritë nga angazhimi
<b>1. Parlamenti dhe komisionet e tij</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>➤ Interesimi i lartë për të përdorur produktet e ZKA-së në dëgjimet e tyre publike;</li> <li>➤ Mbështetja dhe mbikëqyrja e zbatimit të rekomandimeve të auditimit;</li> <li>➤ Shqyrtimi i këshillave dhe rekomandimeve nga Auditori i Përgjithshëm për ndryshimet legjislative;</li> <li>➤ Përdorimi i dëgjimeve publike si një mjet për të inkurajuar zbatimin e rekomandimeve të ZKA-së;</li> <li>➤ Ruajtja e pavarësisë së ZKA –së dhe sigurimi i burimeve të nevojshme.</li> </ul>
<b>2. Ministrinë, agjencitë, komunat, NP-të dhe entitetet e tjera të audituara</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>➤ Ofrimi i sigurisë për pasqyrat financiare dhe menaxhimin financiar;</li> <li>➤ Mbështetje adekuate e punës së ZKA-së, duke pasur një qasje për ofrimin e përgjigjeve;</li> <li>➤ Zotimi për zbatimin e rekomandimeve të auditimit.</li> </ul>
<b>3. Qytetarët e Kosovës</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>➤ Përcjellja e punës dhe aktiviteteve audituese të ZKA-së;</li> <li>➤ Ofrimi i informacionit për nevojat, interesat, dhe pritshmëritë nga ZKA-ja;</li> </ul>
<b>4. Media</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>➤ Raportimi për të gjeturat e ZKA-së në mënyrë të saktë, të paanshme, dhe me angazhim;</li> <li>➤ Mbështetja ndaj kauzës së ZKA-së për promovimin e përmirësimit të vazhdueshëm në menaxhimin e parasë publike në të mirë të qytetarëve të Kosovës.</li> </ul>

<p><b>5. Organizatat e Shoqërisë Civile</b></p>	<ul style="list-style-type: none"> <li>➤ Bashkëpunimi me ZKA-në në iniciativa dhe projekte të ndryshme;</li> <li>➤ Përdorimi i produkteve të ZKA –së për kryerjen e hulumtimeve dhe ekzaminimeve të mëtejme bazuar në të gjeturat e auditimit;</li> <li>➤ Ofrimi i propozimeve dhe informacionit të ZKA-ja për identifikimin e fushave dhe temave relevante për auditim;</li> <li>➤ Promovimi i zbatimit të rekomandimeve të auditimit.</li> </ul>
<p><b>6. Donatorët</b></p>	<ul style="list-style-type: none"> <li>➤ Përdorimi i raporteve të auditimit të ZKA-së në ndarjen dhe dhënien e granteve entiteteve të audituara;</li> <li>➤ Mbështetja ndaj ZKA-së në ngritjen e kapaciteteve përmes trajnimeve dhe iniciativave për shkëmbimin e njohurive;</li> <li>➤ Promovimi i pavarësisë funksionale dhe financiare të ZKA –së.</li> </ul>
<p><b>7. Shoqatat akademike dhe profesionale</b></p>	<ul style="list-style-type: none"> <li>➤ Mbështetja ndaj ZKA –së në zhvillimin profesional përmes trajnimeve dhe programeve edukative profesionale;</li> <li>➤ Ofrimi i ekspertizës në fusha specifike.</li> </ul>
<p><b>8. Partnerët ndërkombëtarë (INTOSAI, EUROSAI dhe organizata të tjera)</b></p>	<ul style="list-style-type: none"> <li>➤ Bashkëpunimi me ZKA-në si një ISA me të drejta të plota në kuadrin botëror, evropian dhe rajonal;</li> <li>➤ Bashkëpunimi në iniciativa bilaterale dhe multilaterale me qëllim të shkëmbimit të përvojës profesionale.</li> </ul>

## 6. SYNIMI I PËRGJITHSHËM I KOMUNIKIMIT

**RRITJA E NDIKIMIT DHE NGRITJA E  
VETËDIJESIMIT PUBLIK RRETH ROLIT TË ZKA-SË**

## 7. QËLLIMET STRATEGJIKE TË KOMUNIKIMIT

**1.**

Promovimi i rolit kushtetues të ZKA-së dhe ngritja e vetëdijesimit publik për rezultatet e auditimit

**2.**

Rritja e llogaridhënies në sektorin publik përmes bashkëpunimit intensiv me Parlamentin

**3.**

Rritja e mëtejshme e ndikimit të punës së auditimit

**4.**

Komunikimi aktiv dhe pjesëmarrja në aktivitete ndërkombëtare

## Qëllimi 1

Promovimi i rolit kushtetues të ZKA-së dhe ngritja e vetëdijesimit publik për rezultatet e auditimit

#	Objektivat e komunikimit	Rezultatet e pritura
1	<b>Të rrisim komunikimin efektiv me palët e jashtme dhe publikun</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Ngritja e vetëdijesimit të qytetarëve për rolin e ZKA-së dhe rezultatet e auditimit, si dhe për të drejtën e tyre për të kërkuar llogari nga autoritetet;</li> <li>• Përgatitja dhe shpërndarja e pakove informuese të palët e jashtme dhe publiku</li> <li>• Krijimi kanaleve të reja të komunikimit për të arritur tek audiencia</li> </ul>
2	<b>Të rrisim më tutje kapacitetet njerëzore për një komunikim dhe angazhim efektiv me palët e interesit</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Rekrutimi i stafit profesional në Departamentin për komunikim</li> <li>• Mbajtja e trajnimeve dhe seminareve profesionale, duke rezultuar me ngritje e kapaciteteve për komunikim dhe prezantimit në publik për menaxhmentin e lartë dhe stafit në Departamentin e Komunikimit</li> </ul>

## Qëllimi 2

Rritja e llogaridhënies në sektorin publik përmes bashkëpunimit intensiv me Parlamentin

#	Objektivat e komunikimit	Rezultatet e pritura
1	Të ndihmojmë Parlamentin në përmbushjen e rolit të tij për t'i kërkuar llogari Qeverisë për përdorimin e parasë publike	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Përdorim më i madh i raporteve të auditimit nga legjislativi;</li> <li>• Mbështetje e vazhdueshme profesionale ofruar për deputetët nga auditorët e ZKA-së;</li> </ul>
2	Të forcojmë më tej komunikimin efektiv me komisionet parlamentare	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Numër më i madh i raporteve të auditimit të diskutuara në komisionet parlamentare (dëgjime publike);</li> <li>• Ndikim më të madh në nivelin e zbatimit të rekomandimeve të auditimit.</li> </ul>

## Qëllimi 3.

### Rritja e mëtejshme e ndikimit të punës së auditimit

	Objektivat e komunikimit	Rezultatet e pritura
1	<p><b>Të promovojmë produktet dhe rezultatet e auditimit të ZKA-së si burime të besueshme për përmirësime në qeverisjen në sektorin publik.</b></p>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Rritje e numrit të rekomandimeve të zbatuara të auditimit;</li> <li>• Ngritje të Transparencës dhe qeverisje të mirë në sektorin publik;</li> <li>• Më shumë bashkëpunim me organet e gjyqësorit dhe strukturat kundër korrupsionit;</li> <li>• Rritje e numrit të referencave nga palët e jashtme të produktet e ZKA-së;</li> <li>• Përdorim më i madh i raporteve të auditimit të ZKA-së nga komuniteti i donatorëve gjatë vendimmarrjes së tyre për dhënien e garantëve organizatave buxhetore.</li> </ul>
2	<p><b>Të krijojmë mjetet dhe mekanizmat e duhura për të përcjellë dhe monitoruar zbatimin e rekomandimeve të auditimit</b></p>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Më shumë komunikim me OB-të për të vlerësuar më tej planet e veprimit për zbatimin e rekomandimeve të auditimit</li> <li>• Publikimi në faqen zyrtare të internetit të ZKA-së dhe azhurnimi periodik i bazës së të dhënave për progresin e zbatimit të rekomandimeve të auditimit nga OB-të</li> </ul>



## Qëllimi 4.

### Komunikimi aktiv dhe pjesëmarrja në aktivitete ndërkombëtare

#	Objektivat e komunikimit	Rezultatet e pritura
1	<b>Të komunikojmë në mënyrë efektive me organizatat audituese botërore dhe rajonale dhe të marrim pjesë në mënyrë aktive në aktivitetet e tyre</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Pjesëmarrja aktive në grupe pune/komisione të INTOSAI-t dhe organizatave tjera botërore dhe rajonale;</li> </ul>
2	<b>Të rrisim komunikimin dhe shkëmbimin e përvoja profesionale me partnerët bilateral</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Zbatimi i aktiviteteve në kuadër të marrëveshjeve bilaterale me ISA-të partnere.</li> </ul>

## 8. MJETET DHE KANALET E KOMUNIKIMIT

Në ditët e sotme komunikimi është bërë më i lehtë se që ka qenë ndonjëherë. Megjithatë, kjo është një sfidë e pareshtur për institucione publike, siç është ZKA-ja, të cilës i duhet të përshtatet vazhdimisht me këtë mjedis komunikimi gjithnjë në zhvillim, në mënyrë që të fitojë vëmendjen e duhur në sferën e mbipopulluar publike.

ZKA-ja është e vetëdijshme për burimet që i ka në dispozicion dhe dëshiron që mjetet dhe kanalet në dispozicion, si ato tradicionale (postat elektronike, televizioni, radio, gazetat, takimet) edhe ato moderne (media sociale) t'i përdorë në mënyrë sa më efektive.

Për t'iu përgjigjur sfidave të tregut të medias, ZKA-ja rishikon dhe modernizon vazhdimisht qasjen e saj të komunikimit, duke pasur gjithmonë parasysh që reputacioni dhe emri i saj janë ndër pasuritë e saj më me vlerë.

ZKA-ja është e vetëdijshme që komunikimi nuk nënkupton vetëm ofrimin e informacionit, por është gjithashtu një proces i ndërsjellë. Prandaj, përveç komunikimit të rezultateve të punës së saj, ZKA-ja ruan kanale të hapura për palët e saj të interesit dhe sidomos për opinionin publik që të marrë reagimet e tyre dhe iniciativa për punën e saj në të ardhmen, në mënyrë që t'i përgjigjet më mirë nevojave të publikut.

Gjatë zbatimit të strategjisë së saj të komunikimit përmes përdorimit të mjeteve moderne elektronike për komunikim, ZKA-ja nuk do ta neglizhojë kontaktin me persona, duke kujtuar kështu se marrëdhëniet dhe diskutimet e drejtpërdrejta krijojnë mundësi për shmangien e çdo dyshimi si dhe për ngritjen e imazhit dhe besimit tek institucioni.

Për të mbështetur në mënyrë efektive Auditorin e Përgjithshëm në zbatimin e kësaj strategjie për komunikim, ZKA-ja angazhon një ekip profesionistësh të komunikimit, të cilët kanë gjithashtu njohuri të mira për institucionin.

## 9. ROLET DHE PËRGJEGJËSITË

Kjo strategji komunikimi është relevante për secilin anëtar të stafit të ZKA-së, të cilët, në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, luajnë një rol në përcjelljen e mesazhit te palët e jashtme të interesit.

Auditori i Përgjithshëm dhe menaxhmenti i lartë i ZKA-së kanë një rol kyç në zbatimin e strategjisë së komunikimit përmes përgjegjësive në vijim:

- Përcjellja e mesazhit kryesor te palët e interesit lidhur me çështjet që dalin nga auditimi;
- Krijimi dhe ruajtja e mirëbesimit dhe besimit në punën e ZKA-së; dhe
- Udhëheqja përmes shembullit lidhur me vlerat e ZKA-së, duke u bërë model për sjelljet dhe qëndrimet që i gjithë stafi duhet t'i përvetësojë.

Udhëheqësi i Departamentit për Komunikim dhe Zhvillim ka për detyrë të përcjellë mesazhet e ZKA-së në mënyrë efektive dhe profesionale te palët e interesit, duke:

- Këshilluar se si të arrihet më së miri audienca e synuar, duke specifikuar formën dhe stilin e mesazhit dhe duke përzgjedhur kohën dhe kanal(et) më të përshtatshme;
- Menaxhuar marrëdhëniet publike të ZKA-së me median, OSHC-të dhe publikun e gjerë përmes faqes së internetit dhe kanaleve të tjera, duke siguruar konsistencë të mesazhit;
- Shërbyer si pikë kontakti e ZKA-së dhe duke menaxhuar e koordinuar përgjigjet e ZKA-së ndaj pyetjeve nga jashtë;
- Marrë pjesë aktive në zbatimin dhe monitorimin e strategjisë së ZKA-së për komunikim;
- Ruajtur dhe azhurnuar mjetet e komunikimit të ZKA-së, përfshirë faqen zyrtare të internetit, intranetin dhe mediat sociale; dhe
- Trajnuar stafin auditues për rolet e tyre përkatëse në procesin e komunikimit.

Përgjegjësitë kryesore të stafit auditues lidhur me komunikimin janë:

- Të kuptojnë misionin, vizionin dhe vlerat e ZKA-së, duke i demonstruar ato në të gjitha kontaktet dhe angazhimet me palët e jashtme të interesit;
- Të ndërtojnë marrëdhënie të forta pune me entitetet e audituara, bazuar në respektin e ndërsjellë dhe në njohjen e roleve përkatëse të auditorit dhe të të audituarit;
- T'i paraqesin rezultatet e auditimit të Parlamenti dhe palët e tjera të interesit ashtu siç autorizohen nga Auditori i Përgjithshëm apo nga Udhëheqësi i Departamentit për Komunikim dhe Zhvillim.

## 10. ZBATIMI, RAPORTIMI DHE VLERËSIMI

Për të arritur synimet dhe objektivat e kësaj strategjie për komunikim, ZKA-ja ka hartuar planin e detajuar të zbatimit për vitet 2020-2022. Ky plan azhurnohet çdo vit.

Departamenti për Komunikim dhe Zhvillim do të ketë për detyrë koordinimin dhe zbatimin e këtij plani. Një grup brenda ZKA-së, i përbërë nga Zëvendës Auditori i Përgjithshëm, Udhëheqësi i Departamentit për Komunikim, Udhëheqësi i Departamentit për Bashkëpunim Ndërkombëtar, dhe Shefi i Kabinetit të AP-së, do të mbikëqyrë zbatimin.

Grupi i punës do të raportojë për progresin në zbatimin e planit te Auditori i Përgjithshëm në baza tremujore.

Vlerësimi do të kryhet nga një ekip i autorizuar nga Auditori i Përgjithshëm.

**Na kontaktoni:**

**Departamenti për Komunikim dhe Zhvillim**

[komunikim@oagks.org](mailto:komunikim@oagks.org)

**+383 (0) 38 6060 04 ext. 1066**